

PARAQITJE NË KOMISIONIN E EKONOMISË, FINANCAVE DHE TË PRIVATIZIMIT, 23 PRILL 2001.

Të nderuar zotërinj deputetë,

Raporti Vjetor i vitit 2000, paraqet zhvillimet më të rëndësishme të ndodhura gjatë vitit në Bankën e Shqipërisë dhe në mjedisin ku ajo vepron.

I. VLERËSIME TË PËRGJITHSHME PËR ZHVILLIMET EKONOMIKE

Zhvillimet ekonomike të viteve 1998 dhe 1999 ishin në tërësi në përputhje me direktivat e programit afatmesëm trevjeçar të zhvillimit të vendit, të përcaktuar në marrëveshjen ESAF2 me FMN, e cila u zëvendësua në dhjetor të vitit 1999 me marrëveshjen PRGF. Synimet kryesore të këtij programi ishin sigurimi i një rritjeje të shpejtë ekonomike, në kufijtë 7-8 për qind në vit në kushtet e ruajtjes së nivelit të ulët dhe stabël të çmimeve të konsumit dhe të kryerjes së reformave institucionale për të mbështetur zhvillimin e ekonomisë.

Objektivat për vitin 2000 u përcaktuan duke marrë parasysh që në këtë vit do të ndikonin mangësitë e vërejtura gjatë dy viteve paraardhëse dhe do të shuhej efekti i krizës në Kosovë. Gjithashtu, synimet kryesore ishin që ky vit të arrinte të kapërcente problemet më tipike të viteve të mëparshme si niveli i ulët i investimeve (të huaja apo të vendit), niveli i ulët i privatizimit të ekonomisë dhe i zhvillimit të reformave strukturore.

Bazuar në këto konsiderata, parashikimi për rritjen reale ekonomike të vendit, në vitin 2000, u caktua 7 për qind; objektivi për inflacionin vit mbi vit u përcaktua në kufijtë 2-4 për qind; deficitin e përgjithshëm buxhetor në 9.4 për qind e PBB-së, prej të cilit 4.3 për qind e PBB-së do të financoheshin me burime të brendshme; ndërsa niveli i rezervave valutore u parashikua i mjaftueshëm për të përballuar 4.6 muaj importe mallrash e shërbimesh.

Kështu, fundi i vitit 2000 paraqet një pamje pak më të ndryshme se sa parashikimet.



Në tërësi është respektuar kuadri i përcaktuar. Madje, disa objektiva janë realizuar në nivele më të mira se sa parashikimi. Ndërkohë, për të tjerë tregues janë vërejtur shmangie të lehta të tyre. Duhet të theksoj që këta objektiva nuk janë statikë. Ata rishikohen në bazë të ecurisë së ekonomisë shqiptare.

Viti 2000 mund të ndahet në dy periudha kohore jo të barabarta:

- periudha janar-shtator ishte e tillë që krijoi optimizëm për ecurinë e ekonomisë dhe u rishikua objektivi për rritjen ekonomike, ndërkohë që ekzistonte dyshimi që inflacioni në fund të vitit përsëri do të ishte në nivele mjaft të ulëta (nën 2 për qind). Optimizmi u shtua sidomos nga ecuria e kënaqshme e procesit të privatizimit të sektorit publik dhe rritja e nivelit të të ardhurave nga ky proces;
- periudha tetor-dhjetor e ballafaqi vendin me krizën energjitike si pasojë e rritjes së çmimeve të naftës në tregjet ndërkombëtare dhe e mungesës së theksuar të furnizimit me energji elektrike. Të dyja këto ngjarje përkeqësuan bilancin tregtar të vendit, duke rritur importet e lëndëve djegëse dhe njëkohësisht çuan në rritje të kostos së prodhimit. Ato ndikuan dhe në krijimin e një klime të përgjithshme pasigurie, kryesisht për biznesin, gjë që në tregjet shqiptare konvertohet me rritje të spekulimeve. Për pasojë, Banka e Shqipërisë kërkoi që autoritetet shqiptare të trajtonin me mjaft kujdes këtë krizë për të mos cënuar sadopak ekuilibrin e arritur.

Kështu, as viti 2000 nuk i shpëtoi “traditës” së krijuar të marrjes së goditjeve, me kah pozitiv ose negativ, nga ngjarje të paparashikuara.

II. PRODHIMI I PËRGJITHSHËM BRUTO

Në vlerësimet më të fundit, të bëra së bashku me FMN-në, gjykohet që në vitin 2000 rritja reale ekonomike të jetë në nivelin 7.3 për qind. Kjo shifër ende nuk është përfundimtare pasi ajo mund të korrektohet diçka edhe me efektet negative, që dha kriza e fundvitit. Megjithatë, një fakt është i sigurt. Për të tretin vit rradhazi është siguruar një rritje e kënaqshme e ekonomisë. Duke gjykuar nga disa tregues të tërthortë, gjallërim ka patur sektori privat dhe sidomos ai bujqësor.

Prodhimi bujqësor, i cili ka peshën kryesore në prodhimin gjithsej të vendit, rezulton me një ritëm rritjeje prej 6.8 për qind nga 5 për qind, që ishte një vit më parë. Kontributin kryesor në këtë rritje të prodhimit

bujqësor e ka dhënë blegtoaria dhe prodhimi i bimëve të arave, përkatësisht në masën 48.5 dhe 44.5 për qind. Gjendja më e mirë e bujqësisë shqiptare pasqyrohet në praninë e prodhimit vendas në treg në sasi më të madhe dhe me çmime më të ulëta, gjë që u shpreh në reduktimin e ndjeshëm të indeksit të çmimeve të produkteve bujqësore dhe në indeksin e çmimeve të konsumit, për periudhën maj-korrik 2000.

Bazuar në analizën e disa treguesve të tërthortë gjykohet që **aktiviteti prodhues në sektorin privat** është gjallëruar. Importi i makinerive dhe pajisjeve, për vitin 2000, në terma realë është rreth 37 për qind më i lartë se një vit më parë. Kjo flet për më shumë investime nga ana e sektorit privat. Po kështu, zërat e tjerë të importit janë dominuar nga lëndë të para dhe gjysmëprodukte si produktet minerale, tekstilet dhe artikuj të tyre të cilët përdoren në industrinë përpunuese të vendit. Ndërtimi vazhdon të ruajë ritmet e rritjes duke përbërë një nga sektorët më vitalë të ekonomisë shqiptare. Konsumi i dukshëm i çimentos gjatë një viti është rritur rreth 47 për qind.

Prodhimi industrial në sektorin shtetëror ka pësuar reduktim të mëtejshëm gjatë vitit 2000. Prodhimi mall i shitur për vitin 2000 paraqitet 10 për qind më i ulët se në vitin e kaluar, ndërsa prodhimi industrial është realizuar 54.3 për qind nga 61.3 për qind që ishte ky tregues një vit më parë. Këto të dhëna duhet të trajtohen bazuar në ndryshimet strukturore në këtë sektor të ekonomisë. Mjafton të përmendim privatizimin e mjaft prej ndërmarrjeve shtetërore dhe për pasojë ato nuk përfshihen më në sistemin e raportimit të ministrive përkatëse. Kjo, automatikisht çon në rënie prodhimi.

Gjallërimi i ekonomisë është shoqëruar me krijimin e më shumë hapësirave për punësim. Numri i të papunëve arriti në 217 mijë vetë ose 23 mijë vetë më pak se një vit më parë. Shkalla e papunësisë, gjatë gjithë vitit 2000, është reduktuar për të arritur në fund të tij në nivelin 16.9 për qind nga 14.6 për qind që është norma e papunësisë së vendeve të tjera të Europës Lindore. Megjithatë, reduktimi i saj pas gati tre vitesh rritjeje përbën një zhvillim me kah pozitiv, zhvillim i cili duhet të ruhet edhe në vitet e ardhme.

Zhvillimet në sektorin e jashtëm të ekonomisë janë ndikuar më së shumti nga tre faktorë: kriza energjitike, rritja e të ardhurave valutore nga privatizimi dhe pushimi i efektit të krizës kosovare. Transaksionet tregtare në mallra u rritën me 9 për qind krahasuar me një vit më parë, shkaktuar kryesisht prej rritjes së konsiderueshme të importeve.



Importet e vitit 2000 janë 14 për qind më të larta se një vit më parë dhe për herë të parë ato kalojnë shifrën e një miliard dollarëve. Rritja e importeve u vërejt në grupin “produkte minerale” me 37 për qind, grup në të cilin përfshihet edhe importi i energjisë elektrike. Importi i mallrave ushqimore për konsum të brendshëm, pavarësisht se rezultoi 5.6 për qind më i ulët se viti 1999, vlerësohet të jetë i lartë.

Kjo, sepse në vitin 1999 kërkesa e brendshme për mallra konsumi ishte më e lartë se normalisht, për shkak të pranisë së një pjese të të shpërngulurve nga Kosova. Megjithatë, zhvillimet në tregtinë e jashtme nuk konsiderohen pozitive. Eksportet janë reduktuar me 7 për qind krahasuar me një vit më parë, gjë që ka ardhur nga reduktimi i eksporteve në grupmallrat tradicionalë si “produktet minerale” në masën 44 për qind. Kjo është pasuar nga rënia e eksporteve të grupit “ushqim, pije, duhan” në masën 4 për qind dhe nga rënia e eksporteve të makinerive e pajisjeve në masën 36 për qind. Për pasojë, deficitit tregtar prej 814 milionë dollarësh amerikanë është thelluar më tej me 23 për qind.

Për vitin 2000, krahasuar me një vit më parë, dërgesat monetare të emigrantëve shqiptarë janë rritur me 46 për qind dhe niveli i investimeve të huaja direkte është rritur në masën 3.3 herë.

Në vitin 2000 vërehet një zhvendosje në nivelin e transfertave private dhe shtetërore në krahasim me vitin 1999. Dërgesat e emigrantëve rriten, pasi niveli i tyre, për shkak të krizës së Kosovës, në vitin 1999 ishte i ulët. Po për këtë shkak, transfertat shtetërore bien në nivelin 58 për qind të transfertave të vitit 1999.

Investimet e huaja direkte vlerësohen në 143 milionë dollarë amerikanë dhe, për herë të parë nga viti 1992, ky zë kthehet në fenomenin dominues të zhvillimeve në llogarinë kapitale. Flukset më të larta të regjistruara deri në vitin 1999 ishin 90 milionë dollarë dhe i përkisnin vitit 1996. Faktori kryesor në rritjen e këtij treguesi ishte privatizimi i ekonomisë publike.

III. KRIZA ENERJITIKE E FUNDIT TË VITIT DHE NDIKIMET E SAJ

Siç e përmenda më sipër, tremujori i fundit i vitit 2000 u ndikua nga kriza energjitike, e cila pavarësisht nga masat e marra për ta administruar me kujdes dhe sa më shpejt, ka dhënë ndikimet e veta negative në ekonomi. Rritja e çmimit të naftës në tregjet botërore u ndoq menjëherë nga tregu i brendshëm, ndërkohë që ulja e çmimit të naftës në tregjet

botërore, megjithë lehtësimin e detyrimeve doganore për importet, nuk u pasqyrua menjëherë në tregun e brendshëm. Meqenëse Shqipëria është importuese neto e produkteve energjitike, rritja e çmimit shtoi koston që duhej të përballonte ajo. Këtij faktori iu shtua edhe rritja e importit të energjisë elektrike si edhe ndërprerjet me furnizim të energjisë faktorë, që kanë çuar në rritjen e koston së produkteve në përgjithësi. Ende nuk është bërë një matje e saktë e koston së krizës energjitike në vend, aq më tepër që ajo vazhdon të jetë e pranishme, ndonëse shumë më e reduktuar. Por, duhet të jetë e qartë që këto ngjarje të paparashikuara nuk kanë kërcënuar rritjen ekonomike. Ato kanë zbehur disi optimizmin e fillimit të vitit 2000 dhe e zgjasin efektin e tyre negativ edhe në vitin 2001. Ngjarje të tilla janë sinjale të mjaftueshme për autoritetet shqiptare që të punojnë duke i parë gjërat në perspektivë me qëllim që ekonomia e vendit të mos mbetet peng i fenomeneve të përkohshme.

Kriza energjitike dha ndikimet e veta kryesisht në sektorin e prodhimit:

- biznese të tëra kufizuan përkohësisht aktivitetin e tyre prodhues;
- prodhimi vendas u vu përballë vështirësive dhe duke mos arritur të furnizohej tregu për shkak të kufizimeve të mësipërme, u shkaktua kërkesë më e lartë për importe;
- aktiviteti i shërbimeve, gjithashtu, u përball me një kosto të shtuar;
- aktiviteti i kredithënies nga bankat u vu përballë vështirësive. Një pjesë e bizneseve, duke mos realizuar dot aktivitet në nivelet e parashikuara, paraqitën probleme me shlyerjen e rregullt të kredive. Një pjesë tjetër e bizneseve duke reduktuar e pezulluar aktivitetin apo duke shtyrë investimet e parashikuara ulën kërkesën për kredi. Ky fenomen ishte më tipik për rrethet e vendit ku edhe mungesa e energjisë elektrike ishte më e theksuar. Për këtë arsye, tendenca e rritjes së nivelit të kreditimit, në tremujorin e katërt të vitit 2000, ishte më e ulët se sa ajo e vërejtur në vitet paraardhëse.

IV. ECURIA NË ÇMIMET E KONSUMIT

Në ligjin “Për Bankën e Shqipërisë”, që ky Kuvend ka miratuar, është përcaktuar si objektivi kryesor “arritja dhe ruajtja e stabilitetit të çmimeve”. Stabiliteti i çmimeve përcaktohet si një rritje vit mbi vit e nivelit të çmimeve të konsumit brenda një kufiri të caktuar të ulët pozitiv. Me kufi të ulët pozitiv, sipas kuptimit që i jepet sot në literaturë, nënkuptohet nivel i indeksit të çmimeve të konsumit, që varion në kufijtë 1-3 për qind. Arritja e këtyre niveleve të ulëta të indeksit do të thotë arritje e



stabilitetit të çmimeve. Mbatja e këtyre niveleve të ulëta nga viti në vit apo nga muaji në muaj do të thotë ruajtje e stabilitetit të çmimeve.

Prej një periudhe trevjeçare në vend janë vërtetuar norma vjetore inflacioni në nivele relativisht të ulëta dhe që kanë patur tendencë rënëse. Nga 8.7 për qind në vitin 1998, inflacioni rezultoi negativ për 1.3 për qind në vitin 1999. Në fund të vitit 2000 inflacioni arriti 4.2 për qind. Në këtë kuptim mund të themi që mesatarisht inflacioni në Shqipëri varion në kufijtë e një inflacioni stabil.

Por, Banka e Shqipërisë po punon edhe për të ruajtur stabilitetin e çmimeve. Për vitin 2000, objektivi për inflacionin u përcaktua në kufijtë 2-4 për qind. Në realitet, objektivi u tejkalua me 0.2 pikë përqindjeje. Shqetësim nuk përbën tejkalimi i objektivit, pasi ai është fare minimal dhe nuk jep efekte negative në ekonomi. Shqetësuese janë fenomenet që ndodhin në ekonominë shqiptare dhe që ndikojnë në lëvizje të konsiderueshme dhe të paparashikueshme të çmimeve të konsumit. Nëse deri në muajin nëntor shqetësimi kryesor i Bankës së Shqipërisë ishte arritja e nivelit vjetor të poshtëm të inflacionit prej 2 për qind, në muajin dhjetor ky tregues u rrit 4.6 për qind duke përmbysur çdo parashikim.

Ecuria e çmimeve të konsumit ndikohet nga një sërë faktorësh. Teorikisht inflacioni është në masën më të madhe një fenomen monetar. Praktikisht ai ndikohet dhe nga faktorë të tjerë. Çfarë do të thotë kjo? Edhe nëse Banka e Shqipërisë ka hartuar dhe ka zbatuar politike të matur e të shtrënguar monetare që i shërben stabilitetit të çmimeve, edhe nëse autoriteti fiskal ka arritur të imponojë disiplinë fiskale më të konsoliduar, përsëri, ekonomia shqiptare, duke qenë një ekonomi ende e pastruktuar mirë prodhon ngjarje e fenomene që zhvlehtësojnë efektshmërinë e politikave dhe japin goditje.

Inflacioni i ulët i trevjeçarit të kaluar ka qenë rezultat i:

- zbatimin të një politike relativisht të shtrënguar monetare dhe i realizimit të të gjithë objektivave sasiore;
- kursit të qëndrueshëm të këmbimit të monedhës së vendit me monedhat e huaja, kryesisht me dollarin amerikan dhe me euron;
- pritjeve që kanë filluar të jenë të pranishme edhe në ekonominë shqiptare. Me përjashtim të fundviteve, ku njerëzit parapërgatiten për një rritje çmimesh, në tërësi, gjatë tre viteve të fundit pati një ambientim të tyre me norma të ulëta të inflacionit, duke çuar për

- pasojë edhe në pritshmëri për norma të ulëta të tij;
- arritjes së konsolidimit fiskal dhe zbatimit të objektivave sasiore për buxhetin e shtetit. Viti 2000 shënoi të tjera zhvillime pozitive në aspektin fiskal. U rrit niveli i realizimit të të ardhurave, sidomos i të ardhurave nga tatimet dhe doganat gjë që flet për përpjekje të shtuara për reduktimin e evazionit fiskal dhe të kontrabandës. Po ashtu, ndryshe nga vite të tjera, ka një realizim më të lartë edhe të shpenzimeve buxhetore duke mbetur si një nevojë përmirësimi i punës në realizimin e shpenzimeve kapitale dhe sigurimi i një shpërndarjeje më ritmike të shpenzimeve gjatë gjithë vitit gjë, që ndikon në një administrim më të mirë të likuiditetit të sistemit bankar;
 - nivelit relativisht të ulët të kreditimit dhe të investimeve në ekonomi. Megjithëse gjatë vitit 2000 kreditimi dhe investimet ishin më shumë se sa në vite të tjera, përsëri nuk janë të tilla që t'i ngjajnë një ekspansioni.

Ndërkohë, rritja e paparashikuar e inflacionit, në fund të vitit 2000, ka ardhur si pasojë e veprimit kryesisht të dy faktorëve: të krizës energjitike dhe të faktorit spekulativ, më saktësisht i rritjes së intensitetit të veprimit të këtij faktori.

Është tashmë e përcaktuar sjellja e çmimeve të konsumit në fund të vitit. Rritja e kërkesës për shkak të festave të sezonit shoqërohet me rritje çmimesh. Ky fenomen po kthehet në një përcaktues të normës së inflacionit dhe me kalimin e viteve sa vjen e rritet. Nga ana tjetër, viti 2000 ishte më favorizues për shtimin e spekulimit në ekonomi, krahasuar me dy vitet paraardhëse, nisur nga përkeqësimi i krizës energjitike në muajin dhjetor.

Siç e theksova më lart, tregu shqiptar reagoi me vonesë kur ishte fjala për uljen e çmimeve të lëndëve djegëse si pasojë e uljes së tyre në tregjet ndërkombëtare. Madje çmimet nuk u ulën as në rastin e heqjes së detyrimeve fiskale për gazin e lëngët. Gjithashtu, fundi i vitit u shoqërua me tri festa dhe jo me dy, siç jemi mësuar në vitet e tjera. Ndikimi i këtij fenomeni ka qenë i konsiderueshëm dhe këtë e vërtetojnë shifrat e faktuara për inflacionin në muajt e parë të vitit 2001. Mjafton të përmend që ndryshimi mujor i inflacionit për muajt janar e shkurt ishte negativ, ndërsa në muajin mars është 0.3 për qind. Krahasuar me marsin 2000, norma vit mbi vit e inflacionit është 2.9 për qind.

Të tilla ngjarje quhen ndikim i sezonit dhe janë faktorë që dalin jashtë pushtetit të kontrollit të autoriteteve. Për këtë arsye, Banka e Shqipërisë



është përqendruar edhe në një tregues tjetër për inflacionin, që njihet me termin inflacioni bazë. Ky tregues eliminon ndikimin e faktorëve të sezonit apo rastësorë, që nuk janë pasojë e politikës monetare të zbatuar dhe mat vetëm ndikimin e politikës monetare. Ky tregues është në studim dhe Banka e Shqipërisë po mendon ta zyrtarizojë atë.

Nuk mund të lejojmë kompromentimin e efikasitetit të politikës monetare nga fakti që, në 15 ditët e fundit të vitit, spekulimi me çmimet e frutave dhe të perimeve, të cilat vetëm për muajin dhjetor u rritën 23 për qind, të çojë në rritje të forta të çmimeve të konsumit në përgjithësi. Për të konkretizuar ndikimin e madh të këtyre fenomeneve mjafton të përmend se norma mujore e inflacionit bazë, për muajin dhjetor ka rezultuar 0.4 për qind nga 4.6 për qind inflacioni faktik. Në nivel vjetor kjo normë është negative për 0.9 për qind nga 4.2 për qind, norma e deklaruar. Kjo do të thotë që inflacioni i fundit të vitit 2000 nuk është prodhuar nga veprimet e politikës monetare, por nën ndikimin e faktorëve të përmendur më sipër: presionit të efekteve sezonale, rritjes së intensitetit të spekulimit dhe klimës së pasigurisë të krijuar nga kriza energjitike.

Pavarësisht nga kjo, Banka e Shqipërisë, duke qenë institucioni më i interesuar për të ruajtur stabilitetin e çmimeve është duke punuar, përveç të tjerash, edhe për zhvillimin e një fushate në publik për të reduktuar spekulimin me çmimet.

V. POLITIKA MONETARE

Politika monetare e hartuar dhe e zbatuar në vitin 2000, në parimet kryesore të saj është e ngjashme dhe mbështetet në të njëjtin model si edhe vitet paraardhëse. Ajo është hartuar duke marrë për bazë objektivin për rritje ekonomike në nivele 7-8 për qind dhe norma të ulëta inflacioni. Zbatimi i kësaj politike kontrollohet nëpërmjet vendosjes dhe respektimit të objektivave të ndërmjetëm sasiore të cilët janë po të njëjtët:

- rritja e ofertës së parasë;
- kufiri i poshtëm për nivelin e rezervës ndërkombëtare neto të Bankës së Shqipërisë;
- kufiri i sipërm për nivelin e mjeteve të brendshme neto të Bankës së Shqipërisë; dhe
- kufiri i sipërm për nivelin e kredisë neto të sistemit bankar për Qeverinë.

Të gjithë këta objektiva u realizuan ose janë më të përmirësuar se sa objektivi.

Rritja vjetore e ofertës së parasë u parashikua në masën 12 për qind. Gjatë vitit 2000 ajo u rrit me 35.2 miliardë lekë ose afërsisht 12 për qind. Në këtë tregues ka ndikuar rritja e parasë jashtë bankave me rreth 18 miliardë lekë, rritja e depozitave në lekë me 6.9 miliardë dhe e depozitave në valutë në masën 10.4 miliardë lekë. Megjithatë, për shkak të aritmisë që vërehet në kryerjen e shpenzimeve buxhetore dhe për përqendrimin e këtyre shpenzimeve në tremujorin e fundit të vitit, sidomos në muajin dhjetor, edhe rritja e ofertës së parasë nuk është simetrike gjatë vitit. E theksoj këtë fakt pasi krijohen vështirësi në fund të vitit për administrimin e likuiditetit si edhe çrregullohen treguesit monetarë.

Vendosja e një kufiri të poshtëm për rezervën ndërkombëtare neto të Bankës së Shqipërisë i shërben ruajtjes së një pozicioni të ekuilibruar valutor të vendit. Në fund të vitit 2000 niveli i rezervës arriti në 445.9 milionë dollarë amerikanë ose 94.3 milionë dollarë mbi objektivin. Rritja e rezervës valutore ka ndodhur kryesisht gjatë gjashtëmujorit të dytë të vitit dhe i dedikohet hyrjeve të valutës në formën e kredive të huaja dhe granteve dhe sidomos hyrjeve më të larta se parashikimi nga privatizmi.

Mjetet e brendshme neto të Bankës së Shqipërisë përfaqësojnë detyrimet që Qeveria dhe bankat e nivelit të dytë kanë ndaj bankës qendrore. Në fund të vitit ky tregues ishte rreth 68 miliardë lekë ose afërsisht 13 miliardë lekë nën kufirin e sipërm të vendosur.

Kredia neto e sistemit bankar për qeverinë shpreh detyrimet që kjo e fundit ka ndaj sistemit dhe niveli në fund të vitit i këtyre detyrimeve ishte 3 miliardë lekë nën kufirin e sipërm të vendosur.

Nga ana tjetër, politika monetare vijoi të zbatohet me kah zbutës. Kjo është reflektuar në reduktimet e vazhdueshme të normës së interesit bazë, të shpallura me vendime të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë. Zbutja e politikës monetare ka qenë graduale me reduktime të njëpasnjëshme dhe pothuaj konstante. Vendimet për uljen e normave të interesit janë marrë duke u mbështetur në nivelin e ulët të inflacionit, në rritjen e nivelit të depozitimeve në sistemin bankar, në qëndrueshmërinë e monedhës së vendit në raport me monedhat e huaja, nga njëra anë, dhe të nevojës për të shtuar financimin e ekonomisë dhe për të mbështetur rritjen ekonomike, nga ana tjetër.



Reduktimi i normave të interesit ka dhënë efektet e veta në eurinë e depozitave, në ecurinë e kredisë, në nivelin e fitimit të sistemit bankar etj.. Depozitat me afat në lekë përbëjnë zërin me peshën më të madhe në totalin e ofertës së parasë me rreth 49.4 për qind. Por, në ndryshim nga vitet e kaluara, gjatë vitit 2000 ritmi mesatar mujor i rritjes së depozitave me afat në lekë ka qenë më i ulëti. Gjatë vitit 2000 këto depozita janë shtuar me 0.3 miliardë lekë çdo muaj nga 1.7 miliardë lekë që ishte shtesa mujore gjatë vitit 1999. Janë të shumtë faktorët që kanë ndikuar në këtë sjellje, por më kryesorët janë:

Ulja e vazhdueshme dhe graduale e nivelit të normave të interesave për depozitat me afat në lekë, duke filluar nga viti 1998 dhe në vazhdim. Individët, për herë të parë, në traditën e vendosjes së kursimeve në bankë, u ballafaquan me nivelin më të ulët të interesave për depozitat në lekë. Në fund të vitit 2000 norma mesatare e interesit për depozitat me afat maturimi tre, gjashtë dhe dymbëdhjetë mujore arriti përkatësisht në 6.9, 7.5 dhe 7.7 për qind nga 9, 9.5 dhe 8.9 për qind që ishin në fund të vitit 1999.

Rritja e depozitave në të kaluarën ka qenë në nivele shumë të larta. Nuk mund të thuhet me saktësi se cili është niveli optimal i rritjes së depozitave në lekë në sistem. Gjatë gjithë periudhës tetëvjeçare që lamë pas, interesat e ofruar kanë qenë të lartë e, për rrjedhim, edhe prurjet në formë depozitash ishin relativisht të larta. Është e kuptueshme që në rrethana të tjera, kur inflacioni është në nivele të ulëta për një periudhë të gjatë kohe, askush nuk mund të presë rritje të tilla si ato, të verifikuara në vitet 1994, 1995, 1998.

Ndërthurja e politikës dhe efekti psikologjik mbi publikun. Megjithëse rasti konkret është i pamatshëm, përsëri propaganda e muajve të parë të vitit, mbi gjoja pasigurinë e depozitave në Bankën e Kursimeve, ka patur një efekt negativ të drejtpërdrejtë në motivimin e individëve për vendosjen e kursimeve në lekë në bankën më të madhe në vend. Edhe pse efektin më të madh ky faktor e dha menjëherë në gjashtëmujorin e parë të vitit 2000, efekti i tij në mënyrë inerciale, u ndje edhe gjatë tremujorit të tretë.

Reduktimi i nivelit të kapitalizimit të të ardhurave nga interesi në depozita. Ulja e normave të interesit ka bërë që të ardhurat nga interesi që kapitalizohen të vijnë duke u reduktuar dhe për pasojë kanë ulur ritmin e shtimit të depozitave. Reduktimi i normave të interesit për depozitat çoi në reduktim edhe të normave të tjera të interesit në

ekonomi. Sot për sot në ekonominë shqiptare studjohen sjelljet e normave të depozitave, *yield*-i i bonove të thesarit dhe i repove si dhe normat e kredive. Ritmi i rënies së *yield*-it të bonove të thesarit për të tri maturitetet ishte më i madh se sa për depozitat. Nëse në fillim të vitit 2000, *yield*-i ishte 14.9, 15.2, 15.7 për qind përkatësisht për bonot e thesarit me maturim tre, gjashtë dhe dymbëdhjetëmuajor, në fund të vitit këta tregues arritën në 7.8, 11.3 dhe 12.3 për qind. Kjo është pasojë e drejtpërdrejtë e konkurrencës në rritje në tregun e bonove të thesarit.

Nga ana tjetër, norma e interesit të kredive ka ruajtur nivele të larta. Kështu, për kreditë në lekë me afat maturimi deri në gjashtë muaj norma mesatare e interesit është rritur nga 20.2 në 21.2 për qind; për kreditë me afat maturimi 6 - 12 muaj norma e interesit ka rënë nga 26.2 në 23.7 për qind; për kreditë me afat maturimi nga 1 - 3 vjet norma e interesit ka rënë nga 26.6 në 23.8 për qind. Më tepër se pasqyrim i kërkesës së shtuar për kredi apo i shtimit të rrezikut për afate të caktuara maturimi, norma e interesit të kredive pasqyron mungesën e konkurrencës në tregun e kredive dhe ofertën e ulët të saj.

Megjithatë, situata në kreditimin e ekonomisë shqiptare pati një ndryshim të mbarë gjatë vitit 2000. Niveli i kredisë së re të akorduar nga sistemi bankar ishte 24 miliardë lekë. Ritmi mesatar i rritjes së tepricës së kredisë çdo muaj ishte 0.5 miliardë lekë ose afërsisht tre herë më i lartë se mesatarja e viteve të mëparshme. Në fund të vitit ky tregues ishte 31 për qind më i lartë se një vit më parë. I konsiderueshëm ishte dhe niveli i shlyerjes së kredive. Kështu, viti 2000 paraqet një situatë më optimiste për aktivitetin kreditues se sa vitet e tjera. Treguesit do të kishin qenë akoma më të lartë në rast se kostoja e kreditimit në lekë do të ishte ulur dhe po të eliminohej efekti i krizës energjitike.

Përsa i përket instrumenteve të përdorura për zbatimin e politikës monetare, viti 2000 ka ndryshim nga vitet paraardhëse. Klima e favorshme, e krijuar në ambjentin makroekonomik mundësoi arritjen e rezultateve të kënaqshme në fushën e zbatimit të politikës monetare me anë të instrumenteve indirekte. Pra, zhvillimi më i rëndësishëm në zbatimin e politikës monetare ishte zëvendësimi i plotë i instrumenteve direkte, konkretisht i kufirit të kreditit dhe i normës së interesit për depozitat me afat në lekë në bankat shtetërore, me ato indirekte.

Nëpërmjet ankandeve të repove dhe konkretisht, nëpërmjet interesit maksimal që Banka e Shqipërisë ofron në treg dhe shumës së rezervave të tepërta të deklaruara për t'u blerë, përçohet politika e bankës qendrore



në lidhje me normat e interesit. Në gjashtëmujorin e dytë të vitit, më saktësisht nga data 27 korrik, datë kur u organizua ankandi i parë i repove, norma maksimale e ofruar nga Banka e Shqipërisë është ulur në mënyrë të vazhdueshme nga 9 për qind në 6.5 për qind, në fund të vitit 2000. Ndërkohë *yield*-i mesatar i ponderuar i ankandit është reduktuar nga 6.7 për qind në 6.5 për qind.

Megjithatë, është ende herët të jepet një gjykim i saktë mbi efektivitetin e instrumenteve të reja të përdorura, për shkak të kohës relativisht të shkurtër të përdorimit. Por, është fakt që në fund të vitit 2000 u regjistruan norma interesi më të ulëta se fundi i vitit të mëparshëm, në të gjitha llojet dhe maturitetet e tyre.

Për vitin 2001 vëmendje kryesore do të ketë përsosja e zbatimit të instrumenteve të reja, përsosje e cila, para së gjithash, nënkupton një përmirësim të të gjitha kanaleve të transmisionit, ku spikasin tregu i parasë, kanalet e kreditit dhe ai i përcaktimit të pritjeve në ekonomi. Për këtë arsye, në muajin dhjetor të vitit 2000 u rishikua e gjithë paketa rregullative për përdorimin e instrumenteve indirekte.

Nga ana tjetër, Banka e Shqipërisë po studjon zëvendësimin e regjimit ekzistues të politikës monetare me regjimin e *inflation targeting*. Aktualisht, Banka e Shqipërisë mendon se janë krijuar premiset e para për ta zëvendësuar regjimin aktual të politikës monetare me regjimin *inflation targeting*. Duke kërkuar ndjesë për përdorimin e termit në gjuhën angleze, me këtë dua të tregoj edhe një herë që ky proces është në hapat e parë të tij dhe madje nuk është arritur ende të përkthehet saktë dhe plotë ky term. Regjimi i ri nënkupton që vendimet e politikës monetare kanë për bazë një raport midis inflacionit të pritshëm në të ardhmen me një objektiv inflacioni të shpallur që më parë.

Me të drejtë çdokush mund të pyesë: A është koha për të adoptuar një regjim të tillë në Shqipëri? Vlerësimi i parë që është bërë nga Banka e Shqipërisë ka rezultuar se aktualisht arrijmë të plotësojmë disa kushte, por pjesën më të madhe ende jo. Kushtet që duhet të plotësojë çdo vend kanë të bëjnë me aspektin makroekonomik dhe me atë institucional.

Në aspektin makroekonomik numërohen katër kritere: inflacioni; kursi i këmbimit; konsolidimi fiskal dhe stabiliteti financiar. Në tërësinë e këtyre kritereve vendi ynë ka një pozicion të favorshëm me dy të parët pasi, gjatë viteve të fundit, tendenca ka qenë ulja e normës së inflacionit ndërkohë që nga viti 1992 zbatohet një regjim luhatës i lirë këmbimesh

valutore. Një regjim i tillë përbën një nga kriteret për fillimin e zbatimit të regjimit *inflation targeting*. Përsa i përket dy kriterëve të tjera mund të them se vitet e fundit kanë shënuar hapa të rëndësishëm edhe në drejtim të konsolidimit fiskal. Megjithatë, nuk mund të flitet ende për konsolidim dhe stabilitet fiskal. Më tej, sistemi mbrojtës i Shqipërisë ndaj krizave financiare ka probleme të shumta, të cilat edhe pse njihen prej kohësh nuk po arrijnë të eliminohen e, për rrjedhim, një kusht shumë i rëndësishëm i *inflation targeting* mbetet për t'u plotësuar.

Aspekti institucional përmban kriterë, të cilat, në një pjesë të madhe, janë të përmbushura pak ose jomjaftueshëm. Kështu, ligji na ofron një pozicion të favorshëm për pavarësinë e bankës qendrore, por, në realitet, pavarësia e bankës duhet forcuar. Nga ana tjetër, Banka e Shqipërisë, megjithë zhvillimet e konsiderueshme të bëra në këtë drejtim vitin e fundit, nuk është tërësisht transparente në thelbin e saj: shpjegimin e procesit vendimmarrës, sidomos për çështje të politikës monetare. Për pasojë, ende nuk mund të thuhet se Banka e Shqipërisë ka fituar plotësisht besueshmëri në publik.

Në Shqipëri, ku inflacioni ndikohet mjaft nga faktorët *shock* dhe ata spekulativë, mundësia e devijimit nga objektivi është e lartë. Së fundi, niveli i bashkërendimit midis autoritetit monetar dhe atij fiskal duhet të ngrihet në nivelin që kërkon regjimi i *inflation targeting*. Pra, nëse në aspektin makroekonomik ekzistojnë faktorë, që të shtyjnë të zgjedhësh *inflation targeting* si regjim të politikës monetare, në aspektin institucional gjykohet se më tepër peshë kanë pikat e dobëta të tij. Mbi të gjitha, adoptimi i këtij regjimi kërkon mbështetje me një informacion të plotë dhe të saktë statistikor.

Për fat të keq, në Shqipëri, ende nuk e kemi një informacion të tillë. Ishte ky shqetësim që çoi në mbajtjen e një konference kombëtare nga Banka e Shqipërisë në bashkëpunim me Institutin e Statistikave dhe institucione të huaja, në muajin nëntor të vitit 2000. Nëpërmjet kësaj konference synuam të tërhiqim vëmendjen për nivelin e ulët të zhvillimit të statistikave dhe për kujdesin e pakët që i është kushtuar këtij problemi. Për periudhën afatmesme, Banka e Shqipërisë beson dhe ka përcaktuar si objektiva të saj angazhimin në përmbushjen e kriterëve për adoptimin e regjimit të *inflation targeting*. Ky proces do të kërkojë kohën e vet, e cila sipas gjykimit paraprak arrin 3 deri në 5 vjet.



VI. ZHVILLIMET NË SISTEMIN BANKAR

Zhvillimi i sistemit bankar shqiptar po shihet aktualisht në dy drejtime kryesore: përmirësimin e aktivitetit bankar të bankave ekzistuese dhe privatizimin e bankave shtetërore.

Në përgjithësi, gjendja e sistemit bankar shqiptar vlerësohet relativisht e shëndoshë. Këtë konkluzion e bazojmë në rezultatin financiar të sistemit për vitin 2000 dhe në pozicionin e kapitalit. Për vitin 2000 sistemi bankar shqiptar ka dalë me fitim prej 5.4 miliardë lekësh ose tre herë më shumë se viti 1999. Si efekt pozitiv vlerësohet sidomos fakti që pas një periudhe katërvjeçare (1994-1998) kur sistemi bankar ka pësuar vazhdimisht humbje, ai del me fitim për dy vite rradhazi. Nga ana tjetër, duke deklaruar që sistemi bankar ka rezultuar me fitim kjo nuk do të thotë detyrimisht që të gjitha bankat e kanë mbyllur aktivitetin e tyre me fitim.

Në biznesin bankar, ashtu si edhe në çdo biznes tjetër, është e natyrshme që të pësohen humbje. Kjo është akoma më e mundur në Shqipëri për shkak të rrezikut relativisht të lartë që ka mjedisi ekonomik, gjë që i ka bërë bankat të adoptojnë strategji konservatore dhe joagresive në drejtim të zgjerimit të aktivitetit. Për këtë arsye, struktura e investimeve të bankave në Shqipëri është e përqendruar në investime pa rrezik ose me rrezik të ulët.

Konkretisht, rreth 66 për qind e aktiveve të sistemit bankar klasifikohen si aktive pa rrezik, 23 për qind si aktive me rrezik të ulët dhe pjesa tjetër si aktive me rrezik të mesëm dhe të lartë.

Kjo strategji mbron nga njëra anë depozitat në banka. Por, nga ana tjetër, të ardhurat që sigurohen nga të tilla investime janë të ulëta dhe në nivele që nuk i mbulojnë shpenzimet ose i tejkalojnë relativisht pak ato. Për këtë arsye, ka edhe disa banka që dalin me humbje.

Për më tepër, kjo strukturë investimesh ka bërë që nevojat për kapital për sistemin bankar të jenë të pakta. Pavarësisht nga kjo, Banka e Shqipërisë ka marrë vendim që të gjitha bankat e nivelit të dytë të rrisin kapitalin e paguar në 700 milionë lekë brenda marsit 2001. Ky vendim është përmbushur prej të gjitha bankave. Gjithashtu, në kuadër të procesit të privatizimit të Bankës së Kursimeve, në fund të muajit dhjetor të vitit 2000 u rikapitalizua Banka e Kursimeve në masën 17.2 miliardë lekë. Këto veprime forcuan pozicionin e kapitalit të sistemit bankar. Raporti i mjaftueshmërisë së kapitalit për fundin e vitit 2000 rezultonte 41.8 për

qind nga 8.2 për qind, që ishte në fund të vitit 1999 apo nga 12 për qind që është niveli minimal i lejuar. Akoma më pozitiv është fakti që për grupin e bankave shtetërore ky tregues është 43.4 për qind nga negativ prej 11 për qind, që ishte një vit më parë.

Një pozicion i fortë kapitali ka rëndësi edhe për perspektivën lidhur me zgjerimin e aktivitetit. Duke patur kapital të mjaftueshëm bankat kanë hapësira të tregohen më agresive për zgjerimin e aktivitetit, sidomos në kredidhënie, pa rrezikuar depozitat.

Por, ende sistemi bankar shqiptar është i segmentuar dhe jokonkurrent. Kjo ka bërë që të mos ketë nxitje për zgjerim të aktivitetit, shtrirje gjeografike, ofrim produktesh të reja dhe, mbi të gjitha, ofrim shërbimesh me kosto të ulët. Sot veprojnë 13 banka në Shqipëri dhe 7 prej tyre kanë degë e agjenci jashtë qytetit të Tiranës.

Disa degë u çelën nga bankat private edhe gjatë vitit 2000. Megjithatë, ende bankat nuk gjenden aty ku duhet të jenë për t'u shërbyer klientëve. Për të nxitur konkurrencën, Banka e Shqipërisë miratoi, në fillim të muajit prill 2001, një dokument për mbrojtjen dhe nxitjen e konkurrencës në sistemin bankar. Ajo, gjithashtu, është angazhuar për të përmirësuar politikën e licencimit të bankave të reja me qëllim që të lejojë hyrjen në tregun bankar të bankave më cilësore dhe që premtojnë për zhvillim të atyre sektorëve apo aspekteve, të cilat janë lënë në hije nga bankat ekzistuese. Banka e Shqipërisë ka përcaktuar diversifikimin e sistemit bankar si një mjet mjaft efikas për të nxitur konkurrencën dhe zhvillimin e tij.

Në vitin 2000, ndodhën ndryshime të rëndësishme strukturore në sistemin bankar duke shtuar peshën e bankave private dhe me kapital të huaj si pasojë e privatizimit të Bankës Kombëtare Tregtare. Kapitali prej 10 milionë dollarësh, paguar nga tre aksionerët e rinj të kësaj banke është një tjetër kontribut në rritjen e nivelit të investimeve të huaja direkte në Shqipëri. Përfundimi i privatizimit të Bankës Kombëtare Tregtare bëri që niveli i kapitalit shtetëror në sistemin bankar të bjerë nga 38.1 për qind, në fund të vitit 1999, në 11.1 për qind në fund të vitit 2000.

Kjo tendencë pritet të forcohet më tej gjatë vitit 2001 me privatizimin e Bankës së Kursimeve. Banka e Shqipërisë mendon që ky proces duhet të tërheqë vëmendjen e të gjithëve dhe të trajtohet me kujdes. Megjithëse deri më sot mendojmë se janë kryer hapat e duhur dhe të nevojshëm për privatizim të Bankës së Kursimeve dhe strategjia e privatizimit të



saj është e orientuar drejt nga rekomandimet që jep teoria për privatizimin, përsëri vlerësojmë që procesi do të jetë delikat. Banka e Kursimeve është banka më e madhe e sistemit bankar shqiptar dhe që dominon mjaft nga aktivitetet bankare si depozitimin, tregun e bonove të thesarit, rrjetin bankar etj..

Në këtë bankë janë përqendruar depozitat e popullatës gjë që rrit ndjeshmërinë e publikut për çdo veprim, që ka të bëjë me Bankën e Kursimeve dhe e ekspozon ndaj rrezikut të spekulimit me të. Shqetësimi i Bankës së Shqipërisë ka të bëjë edhe me ecurinë e bankës pas privatizimit. Sigurimi i një konsensusi të gjerë në mjedisin politik, por edhe në mjedisin e biznesit, për këtë proces privatizimi është i nevojshëm. Ky do të jetë një element garancie shtesë në suksesin e privatizimit. Për t'i shërbyer këtyre qëllimeve Ministria e Financave, në cilësinë e pronarit të Bankës së Kursimeve, dhe Banka e Shqipërisë, në cilësinë e autoritetit mbikëqyrës dhe rregullator të sistemit bankar organizuan, në 20 mars të vitit 2001 një takim diskutimi me pjesëmarrje mjaft të gjerë. Ky takim shërbeu njëkohësisht edhe për t'i dhënë shtysë publicitetit të procesit të privatizimit. Në kushtet kur privatizimi përkon me fushatën zgjedhore dhe situata e acaruar në rajon është faktor që largon investitorët e huaj seriozë, Banka e Shqipërisë vlerëson që i duhet kushtuar kohë dhe energji publicitetit për Bankën e Kursimeve.

Po në këtë kuadër, Banka e Shqipërisë u angazhua në përgatitjen e projektligjit për sigurimin e depozitave, i shqyrtuar tashmë dhe nga Këshilli i Ministrave. Miratimi i një skeme të tillë vë në pozita të barabarta konkurrence bankat në Shqipëri, krijon një siguri për depozituesit e Bankës së Kursimeve që në momentin e parë pas privatizimit të saj duke ulur dhe shkallën e ndikimit të spekulimeve. Ky projektligj, tashmë duhet të jetë në duart tuaja dhe e theksoj që është e rëndësishme që ai të miratohet përpara privatizimit të Bankës së Kursimeve. Miratimi i këtij projektligji përbën dhe një angazhim, që rrjedh nga marrëveshjet me institucionet financiare ndërkombëtare.

VII. OBJEKTIVA PËR VITIN 2001

Për periudhën 1999-2001 Banka e Shqipërisë hartoi strategjinë e zhvillimit afatmesëm institucional të saj. Në këtë dokument u përcaktuan objektivat strategjike dhe rrugët për arritjen e tyre. Megjithatë ende nuk ka përfunduar periudha e kohës gjatë së cilës po punohet për përmbushjen e objektivave strategjike, mund të them, nga një vlerësim paraprak, se Banka e Shqipërisë arriti që, në tërësi, të përmbushë këta

objektiva. Njëkohësisht, deri në fund të vitit do të jetë hartuar dhe miratuar dokumenti i ri për zhvillimin strategjik të Bankës së Shqipërisë për tre deri në pesë vitet e ardhshme. Ndër objektivat apo drejtimet kryesore ku do të përqendrohet puna jonë mund të përmend:

- ruajtja e stabilitetit të çmimeve. Që të realizohet kjo, vëmendja kryesore do të përqendrohet në hartimin e modeleve për parashikimin e inflacionit, të - studimit të mekanizmit të transmisionit të vendimeve në ekonomi dhe të përsosjes së tij;
- përcaktimi i hapave për adoptimin e regjimit të *inflation targeting* dhe përsosja e përdorimit të instrumenteve indirekte për zbatimin e politikës monetare;
- përcaktimi i masave për reduktimin e tregut joformal financiar dhe nxitja e krijimit të tregjeve dhe funksionimit normal të tyre në Shqipëri;
- përafrimi me Bankën Qendrore Europiane në kuadër të zhvillimit të procesit të integritetit të Shqipërisë në BE dhe studimi, mbi këtë bazë, i dobishmërisë së përdorimit të monedhës europiane, euro, në ekonomi;
- përafrimi me standardet ndërkombëtare për transparencën në aktivitetin e Bankës së Shqipërisë;
- rritja e përgjegjshmërisë dhe e besueshmërisë së Bankës së Shqipërisë krahas forcimit të pavarësisë reale të saj.